



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_314_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_458_09_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_458_09_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Shemsi Peshku (shifra e konsumatorit DPR - 41221) nga fshati Barilevë, Besianë, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 19.02.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 28.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 15.06.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr. 5933217 ka pasur vulë distributive me nr. 011812 dhe se i njëjti duhet të ndërrohet dhe dërgohet në qendrën e kalibrimit.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 362726 të datës 04.02.2008

- Me datë 24.08.2009 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë organeve të KEK-ut për ndërrim njehsori.

Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori i datës 24.08.2009

- Me datë 24.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 45813433 si dhe kanë konstatuar se njehsori i vjetër nuk prezantohet nga konsumatori.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000222 datë 24.08.2009

- Me datë 13.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e pajisjeve që posedon konsumatori.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 056335 i datës 13.10.2009

- Me datë 17.12.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP08087 në vlerë prej 456.44 €.
Provë: Fatura DPR09HP08087 e datës 17.12.2009
- Me datë 16.01.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 28.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 28.01.2010
- Me datë 19.02.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 17.09.2010 DMK në ZRRE pas analizave të bëra lëndës së konsumatorit dhe duke pasur parasysh se lexuesi i KEK-ut e ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 59633217 deri në periudhën 07/2008 ka qenë duke regjistruar energjinë elektrike, ku njehsori elektrik ka qenë në rregull dhe ka pasur vulën distributive, ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK_V_458_09_10 duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK:
 1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR09HP08087 të datës 17.12.2009 në vlerë 456.44 €.
 2. KEK-u duhet të ngarkojë konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike vetëm për një muaj (08/2009), kur edhe ka ndodhur ndërrimi i njehsorit elektrik.
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Apelimi i KEK i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_458_09_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi shtesë, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK_V_458_09_10**.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar